

KRITIKË DHE BIBLIOGRAFI**XHEVAT LLOSHI**

NORBERT BORETZKY, DER TÜRKISCHE EINFLUSS AUF DAS ALBANISCHE. TEIL 1. PHONOLOGIE UND MORPHOLOGIE DER ALBANISCHEN TURZISMEN. 1975, 273 F. TEIL 2. WÖRTERBUCH DER ALBANISCHEN TURZISMEN. 1976. 225 F. OTTO HARRASSOWITZ. WIESBADEN. NË SERINË: "ALBANISCHE FORSCHUNGEN", 11 DHE 12.

Libri i Norbert Boretzky-t për turqizmat e shqipes është botuar në dy vëllime më 1975-1976. Tashti pas 40 vjetësh është dukshëm vonë për të bërë recensionin e tij, e njëkohësisht zhvlerësohen mundësitë e frytshme për dialog dhe për bashkëpunim. Megjithatë, ndonëse kanë kaluar disa dhjetëvjeçarë, nuk ka pasur ndonjë shqyrtim thelbësor të këtyre dy vëllimeve, që mbeten punimi më i gjerë i botuar deri më sot për këtë temë mjaft të rëndësishme në studimet për gjuhën shqipe.

Punimet e dijetarëve gjermanë për gjuhën shqipe kanë një traditë të gjatë të frytshme dhe me ndihmesa të paçmueshme. Në gjysmëshekullin e fundit është shfaqur një zhvillim i ri në trajtimet e shqipes nga ana e tyre. Arsyeja është se tashmë për shqipen ka një pasuri të madhe leksikore të dëshmuar në botime të të gjitha fushave, është bërë dhe vijon të bëhet mbledhja e pasurisë leksikore gjithashtu nga burimet gojore, ndërsa gjuhëtarët shqiptarë kanë hartuar fjalorë dhe punime leksikologjike e etimologjike. Nuk është më gjendja e dikurshme, në të cilën J. Xyländer-i, J. G. von Hahn-i ose G. Meyer-i ishin të detyruar me mund të madh të mblidhnin fjalë të shqipes ku të rastiste. Në këto rrethana disa gjurmues gjermanë i kanë hyrë një drejtimi tjetër: krahas gjurmimeve të mëtejshme në rrafsh të gjerë, edhe të shqyrtojnë punimet e autorëve të mëparshëm gjermanë.

Norbert Boretzky për *Ndikimin e turqishtes mbi gjuhën shqipe* ka shfrytëzuar një bibliografi të gjerë, ndërsa lidhur me këtë temë janë përmendur emrat e F. Miklošisch-it, G. Meyer-it, G. Weigand-it, N. Joklit, M. Lambertz-it, W. Fieldler-it.

Vëllimi I (1975) me titullin *Fonologjia dhe morfologjia e turqizmeve të shqipes* ka një Hyrje për ndërtimin e qëllimin e punimit dhe për problemet e tjera. Më pas vjen Pjesa e parë për fonologjinë dhe ndahet në 8 krerë. Me të drejtë që në fillim jepet pasqyra e përgjithshme për shqipen e turqishten,

pastaj merren me radhë ndërrimet tingullore, problemet e theksit, ndryshimet dytësore, zhvillimet e veçanta në dialektet e shqipes, përcaktimi i turqizrave, huazimet e gjuhës së folur e të dialekteve dhe në fund disa dialekte të veçanta. Secili krye është zbërthyer imtësisht dhe çdo paragraf është pajisur me shumë shembuj. Ky ndërtim sipas një strukture gjithëpërfshirëse premt për një hulumtim të thelluar, që do ta çonte ndjeshëm përpara dijen e derisotme. Dhe vërtet në një rast ka konstatime me interes dhe vështirime për dukuri, që nuk ishin rrokur nga gjurmimet e mëparshme dhe autori e vë në dukje, se ato nuk i kishin prekur çështjet fonetike e fonologjike; i kishin krahasuar trajtat tingullore vetëm me turqishten e Stambollit dhe nuk kishin bërë krahasimet në shkallë ballkanike. Mirëpo nga një lexim i vëmendshëm dalin një varg pikëpyetjesh thelbësore.

Është e pamundur që të pasqyrohen të gjitha këto çështje, rrjedhimisht do të ndalem te shqyrtimi më nga afër i disave prej tyre dhe nga kjo del një përfytyrim i mbështetur për tablonë e përgjithshme.

Problemi madhor për çfarëdo tip të huazimeve në gjuhën tonë është ky: **Cili është korpusi i leksikut të shqipes?** A bën pjesë aty gjithçka e rastit, kalimtare, e rrethanave individuale e stilistike, sidomos e kushteve të dygjuhësisë? Shpërfillja e kësaj kërkesë të rreptë shkencërisht do të na çonte në një tablo, në të cilën do të kishim një korpus të greqishtes, latinishtes, turqishtes, sllavishtes dhe sot të anglishtes, të përziera të gjitha bashkë, domethënë një monstër leksikore, por jo një gjuhë reale siç është shqipja. Po sjell ndonjë shembull tepër domethënës.

Jepet nga Boretzky si turqizëm (f. 247): *la ila illallah*, që ardhka nga tq. *lâ ilaheillallah*. Nuk ka në gjuhën shqipe një turqizëm të tillë, por as në turqishten nuk ekzistojnë fjalë të tilla. Autori përpiqet ta mbështesë me arsyetimin që shprehja përdoret në ritet. Është e vërtetë që arabishtja përdoret në ritet myslimane kur lexohet Kurani arabisht, por si mund të flitet për një huazim të tillë turk të shqipes? Madje autori ka bërë një pohim të prerë, se në gjuhën shqipe nuk ka asnjë huazim prej arabishtes ose persishtes, gjithçka paska kaluar nëpërmjet turqishtes. Ky është një pohim antihistorik. Arabishtja është dëgjuar nga minaret në Shqipëri që në ditët e para kur janë ndërtuar xhamitë në shek. XV dhe vazhdon të dëgjohet edhe sot në qendër të Tiranës. Arabishtja është mësuar jo në Arabinë Saudite e në Bagdad, siç e nënkupton autori, ndonëse edhe në vendet arabe shkonin ushtarë shqiptarët, por është mësuar edhe me thupër në dorë në mejtepe e më lart në medrese në trevat shqiptare. Po përmend edhe një fjalë të zakonshme: *duhan*. Është e pakuptueshme përse gjithë etimologët deri më sot na e sjellin nga turqishtja, në të cilën nuk ka një fjalë të tillë, por ka *tütün*. Duhani e kanë sjellë në Shqipëri ushtarët nga vendet arabe dhe e kanë sjellë pas shek. XVII, sepse deri atëherë as në Europë nuk ishte përhapur gjerësisht, si bimë e sjellë nga

Amerika. Gjithsesi, do të pajtohem me autorin, se nuk qëndron termi “orientalizma”, por jo duke ngulmuar se nuk ka huazime përveçse me ndërmjetësinë e turqishtes. Në rast të kundërt, është e pakuptueshme që vetë ka sjellë shembuj të arabizmave, si: *tekrir*, që nuk e ka shqipja; *nafaize-t* është shumësi si në arabishten dhe vetë turqishtja nuk e ka.

Jepet si turqizëm *kilus*. Kjo është fjalë e terminologjisë mjekësore, është lat. *chylus* (nga greq. *chylos*), ndërsa turqishtja e ka marrë nga arabishtja. Mjekët tanë e përdorin me grafinë e latinishtes dhe as mund ta përfytyrojnë, që e paskan marrë nga turqishtja dhe aq më keq, që kjo fjalë qenka në gjuhën tonë të folur nga turqishtja. Si term special, as nuk bën pjesë në korpusin e shqipes, jo më në grupin e turqizimeve të shqipes.

Karajfile trajtohet si përshtatje me ndryshim kuptimi e fjalës për lulen *karanfil*, madje kjo përsëritet dy herë në libër. Asgjë e tillë nuk qëndron, sepse emri i pushkës vjen nga firma italiane prodhuese Carlo e Figlio dhe është rast paronimie. Përgjithësisht ky autor nuk e njuh homoniminë për gjuhën shqipe.

Një lloj gruri quhet në Ukrainë *arnautkë*. Kjo nuk është fjalë shqipe dhe as turqizëm në gjuhën shqipe. Është huazim nga gjuhët sllave edhe për vetë shqiptarët e Ukrainës.

Besoj se shembuj të tillë mjaftojnë. Por në rast se grumbullohen në një vend njësi nga Sicilia e Mandrica, nga Ukraina e Egjipti, nga Presheva e Peloponezi, nga Manastiri e Stambolli, tabloja që del nuk mund të quhet shqipe. Kjo nuk është gjuha jonë.

Më poshtë do të sjell raste të tjera të njësive që nuk janë të shqipes, ndërsa në shënim¹ kam dhënë një listë plotësuese me fjalë nëpër faqet e N. Boretzky-t, të cilat asnjëherë nuk kanë qenë pjesë e korpusit të shqipes dhe nuk mund të ndërtohet mbi to asgjë e vlefshme për gjuhësinë. Nga një varg shembujsh të krijohet përshtypja se autori e ka mbledhur lëndën nga gojeçë, gagaçë, thuthuqë, belbacukë, e ndoshta me të meta jo vetëm të aparatit artikules².

¹ Fjalë që nuk njihen nga gjuha shqipe: *allahtabiler*, *allarametile*, *allah nemrile*, *azhdis*, *baki*, *ballçik*, *baxhallar*, *beli vallahi*, *benis*, *berumbak*, *bezeris*, *bezhdë*, *biçare*, *çitar*, *darmadan*, *dodi*, *don*, *fallxhihanë*, *fëldishtë*, *gazali*, *gibta*, *gjenish*, *haxhusk*, *hënxhir*, *izen*, *kallama*, *kapllamak*, *katie*, *kavgatë*, *kërndellis*, *kiket*, *mahana*, *maskarë*, *masulat*, *mutllak*, *pajtat*, *qesetë*, *saka*, *ses*, *sërrçe*, *suqut*, *syтана*, *takamile*, *talimat*, *tallkin*, *taraki*, *teretut*, *tesvëti*, *tybistik*, *xhandërma*, *xhelatxhi*, *xhezanagdje*.

² Trajta të tilla të shtrembëruara janë: *aqikat* (*hakikat*), *bagaçë* (*pogaçë*), *bahçevanxhi*, *bakfgan* (*fakfun*), *baksëz* (*i pabaft*), *balldane* (*palldëm*), *balldanos* (për: *majdanos*), *barberhanë*, *bukëxhi*, *çemalle* (*qemane*), *çetap* (*qitap*), *çerteli* (*çifteli*), *çerap*, *demi* (*dimi*), *devanhane*, *diverhane* (*divanhane*), *dolldërma*, *dudall* (*budall*), *dullak*, *duvat* (*duvak*), *eb* (*hejbe*), *enk* (*aheng*), *esik* (*eksiq*), *flerexhi*, *freshllëk*, *gastarxhi*, *gjellxheshë*, *hapsanxhi*, *har* (*ahur*), *haritë* (*hartë*), *hashaf* (*hashash*), *hyqamet*, *jashhtëk*, *kaçllëk*, *kadem jazi*, *kallap* (*kallëp*), *konomllëk*, *korme* (*urmë*), *Imaz* (*elmaz*),

Me të drejtë autori këmbëngul, që të merren parasysh turqizmat e mirëfillta, domethënë të marra prej shqipes nga turqishtja dhe jo me ndërmjetësinë e gjuhëve të tjera. Mirëpo në lëndën konkrete ky kriter nuk është zbatuar. Për shembull, kanë ardhur në shqipen jo nga turqishtja, por nga të folmet sllave një varg fjalësh³. Këto nuk duhej të përfshiheshin nëpër paragrafët e ndryshëm. Vetë autori e pranon (f. 237), se në një vjershë të marrë nga turqishtja ndeshen fjalët *jediler* dhe *kërkler*, atëherë ç'punë kanë me turqizmat e shqipes, kur nuk i njeh gjuha jonë? Nuk mund të miratohet që *patrik* qenka huazim nga turqishtja, kur vetë turqishtja e ka marrë nga greqishtja; pastaj, shqiptarët nuk e kanë mësuar ortodoksinë nga turqit. As *cangadhe* nuk është nga tq. *çangal*, por nga greqishtja. Është e pabesueshme (f. 100), që autori quan fjalë të shqipes trajtën *arnáut*, e cila është tipike sllave. Ku janë gjetur këta shqiptarë, që nuk e quajtkan veten *shqiptarë*, por *arnáut*?

Më del se disa autorë të huaj, e në radhë të parë mes tyre Angelo Leotti (Fjalori shqip-italisht, 1937), janë përpjekur të trillojnë një gjuhë shqipe që nuk ekziston⁴, deri duke i "shqipëruar" turqizmat. Për fat të keq, të gjitha këto sajime të kota N. Borecki i ka marrë si të mirëqena, pa asnjë qëndrim kritik, një dëshmi edhe kjo e njohjes së sipërfaqshme të shqipes. Qëndrim kritik duhej mbajtur madje edhe ndaj disa fjalëve nga etimologjitë e G. Meyerit (1891), sepse ishte e natyrshme që dija do të shkonte përpara pas një shekulli, mirëpo N. Borecki i ka marrë si të mirëqena, p.sh. *boga*, *bukagi*, *çik*, *ganilloj*, *geler*, *hajmana*, *kërkma*, *kërnellis*, *muskovnisht*, *suluk*, *zgal*.

Problemi i dytë madhor lidhur me huazimet turke është se shqipja dhe turqishtja janë dy gjuhë të ndryshme, sepse **bëjnë pjesë në dy familje të ndryshme gjuhësh**. Rrjedhimisht, krahasimet nuk mund të bëhen përciptazi

lundërhane, *marmur* (*mermer*), *myslly* (*myflis*), *myshma* (*mushama*), *nënëllëk*, *pacar* (*pazar*), *peden* (*beden*), *pjamber* (*pejgamber*), *pixhak* (*biçak*), *pergjel*, *pleqërrillëk*, *pumuk* (*pambuk*), *qederprurës*, *qulap* (*qylah*), *sanak* (*sënduk*), *taftan* (*kaftan*), *taqi* (*takije*), *taraqi* (*terjaqi*), *taftan*, *tiranalli*, *tyrlysh*, *ushta*, *vath* (*vakt*), *xhap* (*xhëp*), *xhell* (*exhel*), *zalfë* (*zarfë*), *zumbull*.

³ Huazime nga gjuhët sllave dhe jo drejtpërdrejt nga turqishtja: *alltinbash* – tq. *altun bezi* (nuk ka asnjë mundësi që fonetikiisht *bezi* të jap *bash* në shqipen), *bukagi*, *fukaritem*, *gjinë*, *gjyërr*, *haraçnik*, *harxhit*, *kashik* (te F. Bardhi vetëm dhe madje T. Dizdari e shënon se nuk del gjëkund ndër shqiptarë), *kaur*, *llapit*, *shigert*.

⁴ Sajime të autorëve të huaj, që nuk i njeh shqipja: *bollësi*, *bollësisht*, *i boshtë*, *bunartinj*, *daullar*, *daulltar*, *eshktar*, *firarem*, *fodullësi*, *fodullim*, *hajdutsi*, *halltar*, *hapsos*, *hasmëtar*, *i hatërueshëm*, *i idizashëm*, *kallauzis*, *karagojëri*, *i kastilëshëm*, *i katërqoshhtë*, *kurbantore*, *i lazemshëm*, *llapoj*, *i mehanshëm*, *i merkashëm*, *mezatar*, *mushamalizonj*, *nakseri*, *i painsaf*, *i qejfshëm*, *i sabrushëm*, *sagllamëtar*, *i salltanatshëm*, *sallxhakthi*, *serhirtar*, *sermos*, *sertillis*, *shupedis*, *tamamërisht*, *i teneqenjti*, *toptanërisht*, *i tuhafshëm*, *i ujgushëm*, *i xhamllëktë*, *i xhenemtë*, *i xhymertë*, *zanator*, *zullumtar*.

me ballafaqimin e një fjale me një tjetër, por për një fjalë brenda një sistemi tjetër gjuhësor. Për ta konkretizuar këtë po marr pikën për pasqyrimin e tingullit *-a* fundor gjatë përshtatjes në gjuhën shqipe. Autori në mënyrë mekanike ka grumbulluar një listë shembujsh (f. 108), në të cilën ka vënë në kllapa ato që i quan trajta të ndryshuara: *baba (babë)*, *bakllava (bakllavë)*, *baxha (baxhë)*, *budalla (budall)*, *dava (davë)*, *dolloma (dollamë)*, *donama (donamë)*, *hata (hatë)*, *hurma (hurme)*, *llapa (llapë)*, *mahana (mahanë)*, *maskara (maskarë)*, *mastrapa (mashtrapë)*, *masha (mashë)*, *nafaka (nafakë)*, *para (pare)*, *raja (raje)*, *salla (sallë)*, *saraxha (saraxhë)*, *sërma (sërmë)*, *sofa (sofë)*, *sufra (sofra)*, *shaka (shakë)*, *turra (turrë)*. Përveç të metës së përgjithshme, që ka midis këtyre trajta të gabuara, në këtë mënyrë autorit i ka shpëtuar një dukuri thelbësore e shqipes. Vërehet qartë edhe nga këta shembuj, se trajtat me theks fundor janë të të folmeve jugore, ndërsa ato me theks parafundor janë të të folmeve veriore. Ky është një tipar që nuk mund të shpërfilllet. Ndërkaq, këtu nuk është puna për një tingull fundor, po për procese komplekse.

Nuk është e vërtetë, se p.sh. fjala e turqishtes *babá* nëpërmjet një ndryshimi tingullor del në gegërishten *bábë*. Thelbi këtu është te zhvendosja e theksit, e ndërthurur me trajtat morfologjike. Shqipja është gjuhë eptimore, flektive dhe kjo përcakton gjithë ndryshimet që ndodhin gjatë përshtatjes së një fjale turke në sistemin e shqipes. Konkretisht tq. *babá* do të përfshihej si emër, duke marrë në radhë të parë trajtat dhe gjininë. Shqip *babá* do të bëhej emër mashkullor, pra *babái*. Në gegërishten me zhvendosjen e theksit fjala del *bába*, kështu që nuk është e vërtetë se në gegërishten mungon trajta *baba*. Por ajo del kështu emër femëror si *dera*, *dora* etj. dhe normalisht do të ketë trajtën e pashquar *bábë*, rrjedhimisht kemi njëjën e pasme joshquese dhe jo një ndërrim fonetik, ndërsa në shqiptimin e folur, ashtu si dhe për emrat e tjerë të shqipes, zanorja fundore mund të mos dëgjohet, e kompensuar me një zgjatje të zanores së theksuar [báb]. Shumësi i kësaj fjale përdoret rrallë dhe është huazuar bashkë me shumësin e turqishtes *baballar-*, por sërish duke u përfshirë në sistem *baballar-ë*, *-ët*. Për gegërishten në gjuhën e folur del edhe *bába-t* (e ka Fjalori i Bashkimit, 1908).

Ndërrimi i vendit të theksit, siç vihet re, shoqërohet me ndryshimin e gjinisë. Edhe kjo është dukuri më e gjerë, prandaj shkurt po sjell shembuj, si: *komshi*, *-u* dhe *komshi*, *-a*; *efendi*, *-u* dhe *efendi*, *-a*. (krahaso serb. *efendija*, *komšija*). Do të shtoja këtu shembullin *shan-shani*, në të cilin sipas autorit kemi një prapashtesë abstrakte *-i*, kur puna është fare e thjeshtë: është trajta e shquar.

Meqë kemi zhvendosje të theksit, atëherë shtrohet pyetja në një plan më të përgjithshëm për këtë dukuri. Pa hyrë në të gjitha hollësitat, po shënoj se fjalët turke me rrokje të mbyllur nuk e kanë ndërruar theksin: *bilbil*, *kapak*, *pazar*. Nuk e kanë ndërruar edhe fjalët me *-i* fundore: *çati*, *komshi*, *xhami*, *zanaççi*. E kanë ndërruar fjalët me *-ë* fundore të theksuar: *penxherë*- *penxhere*,

teneqé- teneqe, tenxheré- tenxhere dhe pikërisht ky ndryshim përkon sërish me ndarjen ndërmjet dialekteve kryesore të shqipes. Këtu ka nevojë të gjendet një shpjegim. Më duket se arsyeja është te kontaktet e shqipes në shkallë ballkanike. Zonat veriore kanë qenë në kontakt me gjuhët sllave, në të cilat nuk shfaqet theksi fundor, p.sh. serb. *ága, páša*. Në zonat jugore kontakti ka qenë më i afërt me bashkësitë turke ballkanike, ndërsa edhe greqishtja ka ruajtur theksin fundor për këtë klasë fjalësh. Rrjedhimisht, në jug dëgjohej e njëjta trajtë për turqishten dhe për greqishten dhe nuk shfaqej shtysa për një zhvendosje në shqipen. Në veri dëgjohej e njëjta trajtë edhe për serbishten, ndërkohë që zhvendosja e theksit nuk përftonte diçka të huaj për sistemin fonetik të shqipes dhe ja përse: ky ndryshim shfaqet deri te ndonjë pashirmë: *úa* në toskërishten dhe *áu* në gegërishten.

Do të pranojmë se modeli themelor i fjalës shqipe është një njësi kryesisht dyrrrokëshe, po edhe trirrokëshe, me theks parafundor. Edhe këtu ka nevojë të mbahet parasysh sistemi gjuhësor dhe jo të operohet me njësi të veçuara. Kështu, natyrisht që *mal* është fjalë njërrrokëshe e marrë kështu, mirëpo ajo del rregullisht dyrrrokëshe dhe madje trirrokëshe në tërësinë e eptimit të vet: *mali, malit, malet, maleve*. Po kështu ndodh edhe me foljet: *hap* është brenda një paradigme: *hapa, hapim, hapur* etj. Prirja në shqipen për një fjalë dyrrrokëshe me theks parafundor shfaqet e qartë në shkurtime e emrave të përveçëm: *Ibrahím > Bími, Abdurrahím > Dúro, Muhamét > Méti*. Por sidomos kështu mund të shpjegojmë proceset e sotme. Në gjuhën standarde një varg turqizmesh nuk janë pranuar me theks fundor, si *básme, húrmë, máshë, sófër, tenxhére* etj. Disa vijojnë të paraqiten në të dyja trajtat: *tenéqe e teneqé* dhe ndër këto ka raste përshtypjelënëse, si çiftet: *káfe – kafé, pashá – páshë*. Shkurt, të gjitha këto anë shumë interesante për këtë lëmë studimi as që janë kuptuar nga autori për shkak të metodës së tij mekanike dhe mosnjohjes së thelluar të sistemit të shqipes. Madje edhe në paraqitjen mekanike ka cene. Për shembull, nuk i kanë tërhequr vëmendjen rastet e shmangieve, si p.sh. për *pará – páre* ose *basmá – básme*, që duhen shpjeguar.

Problemi i tretë madhor janë **variantet gjuhësore**. Çdo gjuhë me jetë të gjatë e të gjallë paraqitet me një varg variantesh sipas veçantive të historisë së vet. Së pari, me fillimin e shkrimit bëhen të shquara gjuha e shkruar dhe gjuha e folur. N. Borecki ka përdorur termin “turqishte e shkruar”. Në këtë rast ky është një përdorim i pakuptimtë. Gjatë shekujve të sundimit osman shqiptarët nuk kanë qenë në kontakt me turqishten e shkruar, por me osmanishten. Osmanishtja nuk është turqishtja e shkruar, por një gjuhë më vete, për të cilën natyrshëm ka fjalorë dhe gramatika përkatëse. Pa u zgjatur, do të bëja një krahasim: osmanishtja është si latinishtja kundrejt italishtes, si sllavishtja e vjetër kishtare kundrejt rusishtes. Prandaj Dante Aligieri mbrojti italishten si gjuhë edhe të poezisë, ndërsa A. Pushkini rusishten për të njëjtën arsye. Edhe

në Turqi ka pasur një rrymë për të sjellë ndryshime të ngjashme në pjesën e dytë të shekullit XIX dhe në këtë rrymë ka punuar edhe Sami Frashëri. Nuk mund të përimitohet këtu kjo çështje e gjerë, por është e pakuptimtë, që në librin e vet N. Borecki nuk e përmend osmanishten. Madje këtu ndërlikohet edhe arabishtja si gjuha e shkruar e paprekshme e myslimanizmit. Ndërkaq, nuk është turqizëm *rubajat*, por arabizëm te ne me përdorim individual, sepse turqishtja e ka *rubai* dhe kjo është trajta e termit letrar në shqipen, domethënë një term i posaçëm. Do ta kishte vendin këtu edhe trajtimi i historizmave dhe i ekzotizmave me prejardhje nga turqishtja dhe po ashtu përdorimi për nevoja stilistike të citimeve nga turqishtja, përftesë e cila del dukshëm në shkrimet e Gjergj Fishtës dhe të Fan Nolit, në shkrimet humoristike e madje në polemikën publicistike në kohët e sotme, por për të gjitha këto anë thelbësore nuk ka gjurmë në librin në fjalë, ku gjithçka është përmbytur nga vëmendja ndaj lëndës dialektore pa ndonjë rëndësi thelbësore. Shprehja e autorit (f. 14), se duhet mbledhur gjithë lënda e huazimeve turke të shqipes është një fikSION, një ndjekje e një fantazme, në rast se nuk ndiqen kritere studimore si në çdo fushë gjurmimi shkencor.

Së dyti vjen variacioni krahnor. Natyrisht, turqishtja ka dialektet dhe të folmet e veta. Mirëpo në asnjë mënyrë nuk mund të zbatohet i njëjti qëndrim si në rastin e dialekteve të greqishtes dhe të gjuhëve sllave, me të cilat ka qenë në kontakt shqipja. Huazimet nga sllavishtja dhe greqishtja e kanë të ndjeshme praninë e dialekteve të tyre me zonat e arealit të shqipes. Madje, p.sh. vërehet një dallim ndërmjet trevave veriore në kontakt me serbishten dhe trevave më jugore, në kontakt me bullgarishten, që e dëshmon shembulli i mjaftueshëm i fjalës *opangë – opingë*. Një dallim i tillë për një turqizëm ndeshet edhe për fjalën e njohur *beg/bej*, siç dëshmohet që nga vetë emri *Skënderbeu - Skanderbegu*; për pasojë trajta *beg* shkon me gjuhët sllave.

Përkundrazi, nuk ka qenë diçka e zakonshme kontakti i shqiptarëve me popullsi që flisnin dialekte të ndryshme dhe kjo të ndikonte në natyrën e huazimeve turke. Vërtetimi më i dukshëm është fakti, që kur u shkëput Shqipëria nga Turqia, nuk mbetën enklava turke në territorin politik shqiptar. As mund të hamendësohet për dallime dialektore të turqishtes, që kanë lënë gjurmët e tyre te shqiptarët të cilët punonin në Stamboll, që shkonin ushtarë, apo anasjelltas, prej turqve që punonin në administratë, në drejtësi, në ushtri dhe në institucionet fetare në Shqipëri. Gjithsesi, është një fushë e veçantë studimi i dallimeve të huazimeve në gjuhën e folur shqipe, nga njëra anë, dhe i pranisë së turqizmave në gjuhën e shkruar për nevojat shtetërore e fetare, nga ana tjetër, dallim që është edhe për vetë turqit. Ka qenë e përhapur thënia “shqipja e Elbasanit dhe turqishtja e Stambollit” që në mesin e shek. XIX, e cila dëshmon se te shqiptarët nuk kishin prestigj luhatjet dialektore të turqishtes. Nga ana tjetër, ne kemi sot një tablo jo të keqe të veçorive

dialektore të shqipes. Natyrisht, është e nevojshme të vijohet puna, por nuk i duhet dialektologjisë shqiptare të hulumtojë si janë trajtuar fonetikisht turqizmat në çdo të folme. Ato janë trajtuar brenda sistemit dialektor përkatës, domethënë në qoftë se në ndonjë të folme lindore ndeshet zberthimi i tingullit *-í* afërsisht në [aj], domethënë ndeshet [majr] për *mirë*, nuk ka përse të shihen turqizmat e këtyre të folmeve, sepse natyrshëm edhe *raki* do të shqiptohet [rakaj] krejt pavarësisht nga etimologjia e saj. Gjurmuesi ynë i shquar në këtë fushë, Tahir Dizdari, sa herë ka pasur mundësinë, e ka treguar qartë se si një turqizëm ka pësuar ndryshime pikërisht në një rreth të ngushtë të një të folmeje, p.sh. thotë se *boshline*, *henk*, *kapodai*, *koçak*, *koçobash* janë variante vetëm të katolikëve të Shkodrës. Këto janë ndryshime dytësore, që nuk kanë të bëjnë me etimologjinë e fjalëve.

Variacione të një gjuhe shfaqen edhe në kushtet e dygjuhësisë. Dëshiroj ta përsëris prerazi, se nuk mund të pranohen si pjesë përbërëse e shqipes as fjalët dhe as dukuritë, që vërehen në një mjedis dygjuhësh. Kjo është një fushë e veçantë studimi, ndonëse është e sigurt, që një shumicë huazimesh vijnë nga rrethanat e dygjuhësisë, por meriton vëmendje vetëm ajo lëndë, që kalon përgjithësisht në gjuhë dhe jo që gjëllin te folësit dygjuhësh. Mjaft shembuj te libri i N. Boreckit janë marrë pikërisht nga mjedise dygjuhëshe dhe bien poshtë tërësisht. Nuk mund të barazohet dygjuhësia e shqiptarëve me greqishten dhe gjuhët sllave kundrejt një dygjuhësie të kufizuar me turqishten Dygjuhësia me greqishten dhe me gjuhët sllave është shumëshkullore dhe e gjallë edhe sot te shqiptarët, por kjo është tjetër temë. Gjithashtu temë tjetër është shumëgjuhësia mes turqishtes, arabishtes e shqipes. Nuk do të shtoj këtu një këndvështrim tjetër mjaft interesant, që është roli i turqishtes për gjithë gjuhët e Ballkanit gjatë sundimit osman. Do të pranojmë se turqishtja ishte për shekuj gjuha e “globalizimit osman” dhe padyshim ky këndvështrim do të na ndihmonte për të hapur aspekte të tjera edhe për studimet krahasuese në shkallë ballkanike.

Gjuhët kanë variante historike. Nuk ka asnjë gjurmë te ky libër për këtë fakt të rëndësishëm. Aty çuditërisht nuk diskutohet për ngjarjen e madhe historike të shkëputjes së Shqipërisë nga Perandoria Osmane dhe për pasojat e ndjeshme mbi gjendjen gjuhësore të kontakteve me turqishten dhe mbi orientimin kulturor kombëtar. Si rrjedhim, lënda e librit është shumë larg nga gjendja e sotme e turqizmeve në shqipen, aq sa krijohet përshtypja që gjurmime të tilla i shërbejnë gjuhësisë turke dhe jo albanologjisë.

Në vend të problemit të katërt i vjen radha një problematike, në të cilën do të përfshihen pohimet, që nuk qëndrojnë lidhur me gjuhën shqipe.

– Nuk është e vërtetë, që në shqipen prapashtesa *-je* përdoret vetëm për emrat prejfoljorë dhe, për pasojë, qenka “ndërtim i pazakonshëm” (f. 256)

fjala *okje*. Nuk janë të paktë shembujt nga temat emërore të shqipes: *barkje, elbje, dorje, gurje, mishje, përdhesje, përparje*.

– Nuk është e vërtetë (f. 42), që në shqipen tingulli [xh] ka qenë i rrallë dhe është bërë i dendur nën ndikimin e turqishtes. Në shqiptimin e folur është krejt i natyrshëm sonorizimi i parashtesës ç-, si te fjalët: *xhvesh, xhvoshk, xhdëmtoj, xhgërrryej, xhvidhos*.

– Nuk është e vërtetë (f. 43), që në shqipen tingulli [ë] nga periferik është bërë qendror nën ndikimin e tingullit përkatës të turqishtes. Gjuhësia jonë e ka trajtuar hollësisht si një nga dallimet kryesore dhe të vjetra ndërmjet dy dialekteve të shqipes, që dëshmohet p.sh. me fjalët: *ranë – rërë* dhe *baj – bëj*.

– Nuk është e vërtetë (f. 153-154), që rënia në shqipen e tingullit nistor [h] vjen si ndikim nga ndërmjetësimi i gjuhëve sllave. Ky tingull bie si veçori dialektore ose si dukuri e gjuhës së folur pavarësisht nga çfarëdo ndikim prej gjuhëve sllave, sepse nuk është i fortë në atë pozicion, si dhe në gjithë të folmen e Korçës dhe pjesërisht të Dibrës. Del si gabim edhe në shkrim, prandaj shumë vite më parë (14 mars 1971) kam botuar një artikull me titullin “Pse më ani”?

– Nga fusha e fjalëformimit po rendis një pikë me natyrë më të përgjithshme. Sipas autorit (f. 52) është huazuar tq. *arapçá* dhe kjo paska dhënë shqip *arapçe*. Turqishtja e ka prapashtesën në dy variante në përputhje me sinharmoninë zanore: -ça/ -çe. Shqipja nuk e ka huazuar kërkesën e sinharmonisë, siç ka bërë në rastin e prapashtesës -lar/ -ler. Arsyeja është se në shqipen ka një prapashtesë -sh, -she, -shë. Në varësi nga tingulli fundor i temës fjalëformuese ajo del si -çe, p.sh. *fshat>fshatshe> fshaçe; vend>vendshe>vendçe*. Shqipja ka edhe një prapashtesë -çe huazim sllav dhe kështu nuk ka qenë e vështirë të hynte në përdorim edhe -çe e turqishtes, por jo -ça. Rrjedhimisht, *arapçe* nuk vjen nga *arapçá*, por është formim brenda shqipes. Nuk ka kuptim që të ndërtohen fjalë të hamendësuara të turqishtes (f. 174) si: **başıbozukça, *çifutça, *çobança, *haydutça, *sokakça*, sepse në mënyrë të rregullt ato janë formuar në shqipen *hajdut> hajdutshe* ose drejtpërdrejt *hajduçe; sokak>sokakçe*. Nuk hyn aspak këtu fjala *kapanxhë*, e cila vetëm në variant dialektor është *kapanxe* prej tq. *kapança*, sepse për gjuhën shqipe këtu nuk ka asnjë lloj prapashtese. E njëjta gjë vlen për rastet e tjera, si p.sh. *gjoksore* nuk është huazuar nga turqishtja, por temës së huazuar *gjoks-* i është shtuar një nga prapashtesat më të përdorura të shqipes.

– Nuk mund të miratohet pohimi (f. 225), se shqip *hyzmeqare* është huazuar drejtpërdrejt nga turqishtja *hizmetkar*. Huazime të tilla kanë ardhur në shqipen si emra mashkullorë dhe pastaj janë ndërtuar njësitë për gjininë femërore. Dihet se emrat femërorë të profesioneve, të etnive, të pëkatësisë gjeografike e krahinore, të veçorive fizike e psikike ne i ndërtojmë nga mashkullorja: *punëtor – punëtore, mësues – mësuese, grek – greke, përtac –*

përtace, tiranas – tiranase etj. Një pohim i tillë bie ndesh tërësisht me formimet pak më të ndërlikuara. P.sh. nga tq. *bey* kemi *bej/beg* dhe prej tyre *bejlereshë/beglereshë*. Si do t'i shpjegonte atëherë autori formimet nga *budalla* për femërorët: *budallaqe, budallçkë, budallonjë, budalle, budallicë, budalleshë*? Të gjitha këto qenkan huazim i drejtpërdrejtë nga tq. *budalá*?

– Nuk ndodh ndonjë mbiemërzim i emrave me përdorim përforcues, si p.sh. i *hale* për “i ndyrë”. Kjo është dukuri e zakonshme për shqipen, si në rastet *akull* (i ftohtë), *dëborë* (i bardhë). Këto i kemi shënuar si përdorime mbiemërore në fjalorët tanë, por morfologjikisht nuk janë mbiemra, nuk marrin trajtat e mbiemrit. Edhe *shakllaban* nuk është mbiemërzim, ngaqë edhe në turqishten paraqitet si emër e si mbiemër, por sepse kjo është dukuri plotësisht e zakonshme për shqipen, domethënë *punëtor- i/punëtor-e* dhe një numër i pafund fjalësh të tilla në shqipen dalin rregullisht si emra dhe si mbiemra. Gjithashtu i ka të vetat shqipja përdorimet e emrave si ndajfoje, p.sh. për të shënuar një shumësi të madhe: *mizëri, mizë, rrush, prush, lumë*; rrjedhmisht, kështu shfaqet edhe ndonjë huazim, si *deng, top*.

Autori i merr këto raste si dëshmi për “një intensitet të madh të ndikimit të turqishtes” (f. 239) dhe një pohim të tillë të papranueshëm e mbështet me shembujt: *akibet, çatall, hakikat, rehat, sefte*, duke na çuditur se ku i ka gjetur si ndajfolje fjalët *axhele, hakikat* etj.

– Nuk janë lidhëza (f. 246) në shqipen: *anxhak, demek, gjoja, madem*.

– Nuk ka pasthirrma të tilla në shqipen: *baxhallar, dost, çik, dura, helbete, hoshbullduk, qorolla*. Kjo e fundit, për shkak të homonimisë me *qor* do të ishte fyese si përhëndetje.

– Është krejt i panevojshëm paragrafi 3.1 (f. 252) “Ndërtimi i emrave”, sepse fjalë të prejardhura nga tema të turqishtes ka rregullisht po ashtu si për fjalë me tema të vetë shqipes, domethënë *arap – arapeshë* është sipas modelit *bujk – bujkeshë*. Si gjithnjë, edhe për këtë rast mungon përgjithësimi, domethënë që shembujt e fjalëve të prejardhura nga tema të turqishtes dëshmojnë se këto tema janë përvetësuar mirë në shqipen dhe prandaj zakonisht nuk janë zhdukur nga përdorimi, siç ka ndodhur me mijëra fjalë të tjera, që kanë mbetur të izoluar.

– Nuk ka nevojë të trajtohen me huazimet nga turqishtja fjalë të shqipes, si: *elefant, kalibër, magji, parajsë* etj. Ndeshen herë pas here edhe trajtime të tjera, që nuk kanë lidhje me objektin e punimit.

– Nuk ka asnjë gjasë, që shqipja të ketë marrë nga “turqishtja e shkruar” fjalë si: *astragaç, dogëndis, gjybeke, tegel* etj. Çfarë libra turqisht (me shkronja arabe!) paskan lexuar gratë shqiptare (për fat të keq gjerësisht analfabete!) për të mësuar astragaçin e tegelin?

– Edhe nga autorë të tjerë ka një paqartësi të madhe për kompozitat e shqipes; mjaft togfjalësha paraqiten me shkrim si një fjalë e vetme. Mjafton të

shpjegoj një shembull. Nuk ka në gjuhën shqipe një kompozitë *akshampazar*. Fjalët shqipe nuk kanë dy theksa me vlerë të njëjtë. Ndërsa për këtë shembull na ndihmon edhe një thënie e njohur: *aksham pazar – batakçi mall*. Do të duhej të prananim se paskemi edhe kompozitë *batakçimall*, diçka absurde. Rrjedhimisht, nuk qëndrojnë raste të tilla: *specadolma, kafepijetore, pushimdyfek* dhe nuk duhen shkruar si një fjalë; e fundit prej këtyre është një shëmtim që nuk e ka shqipja. Këtu do të shtoja fjalën *telshkrim* (f. 271), që gjithashtu nuk ekziston në leksikon e shqipes dhe aq më pak që këtu pjesa e parë qenka *tel-* e turqishtes. Ky është një kalkim po aq i shëmtuar nga *telegraf*, ku pjesa e parë është nga greqishtja, por është pjesë e fjalëve ndërkombëtare, si: *televizor, teleskop* etj.

Vëllimi i dytë është një *Fjalor i turqizmeve të shqipes* (1976). Ka një hyrje të shkurtër “Vërejtje për fjalorin”, duke treguar se është lënda që ka shërbyer për trajtimin në pjesën e parë. Janë përfshirë edhe pak fjalë me prejardhje të pasigurt nga turqishtja. Për lëndën nga dialektet tregohet se për Preshevën dhe Dibrën mbledhja është bërë nga burimi gojor, kurse për Drenicën, Zadrimën dhe Çamërinë nga burimet e shkruara. Në fund jepet një listë e literaturës së përdorur, por bie në sy, siç e pranoni edhe vetë autori, që nuk ka shfrytëzuar letërsinë e pasur shqipe. Dalin vetëm tre emra shkrimtarësh: S. Hasani (1964), S. Imami (1964), J. Xoxa (1958). Kjo e shpjegon varfërinë e madhe të këtij fjalësi, sepse gjithsej janë rreth 5000 njësi, por një pjesë e madhe e tyre janë gjithfarë trajtash dialektore dhe fjalë që nuk janë turqizma të shqipes. Të gjitha të metat e përmendura për vëllimin e parë gjenden në këtë fjalës, i cili rrjedhimisht as që mund të quhet “Fjalor i turqizmeve të shqipes”. Prandaj nuk e vlen të bëhet një analizë e tij. Po sjell vetëm ndonjë shembull plotësues për të dëshmuar se një grumbullim i tillë është i padobishëm.

Jepet si trajtë e parë *bakallhone* nga Presheva dhe nuk gjendet trajta *bakallhanë*, ndërsa *bakallanë* unë e kam gjetur në shtypin shqiptar që më 1911. Jepet si trajtë e parë *afërim* për *afërim*, trajtë e marrë nga A. Leotti dhe që nuk ekziston në gjuhën shqipe, pastaj vijohet me trajta të tilla nga A. Leotti, si: *alles, ankran, baglladi, batakëri, baxhosxhi, berberië, delldisem, erqani-harp, felaqet, gjeremes, gjëllxheshë, haham, harramxhi, hasmeshë, hekurxhianë, irshat, jollxhi, jomak, kafe-ibrik, kapkanë, kapsanë, katërqoshellikçe, kryetopçi, masip, matrapasxhi, menaf, mesleq, mirimall, mualifllëk, muamelexhi, muhim, mynexhim, mystade, pilaçfi, pishdar, preçartllëk, rakixhi, remall, rynxhuk, sahatçillëk, saka, sandraç, skambil, sukçi, shorollop, tesvëti, tibbie, tiftik, tihaqim, triqoshore, utllaqe, vezaxhi, xhevahirxhi, xhirit, zëtlëk, ziraat*. Po të shtojmë këtu, se janë edhe fjalët, që i kam treguar në shënimin 4, si dhe fjalët shqipe me ndonjë prapashtesë turke (d.m.th. *tërthorçe* qenka huazim nga turqishtja!), atëherë dalim jashtë asaj që quhet shkencë gjuhësore. Nuk do të prek fjalë të njohura, që mungojnë, si *bajame* apo *barbunjë*.

Në faqet 147-207 jepen pesë lista turqizmesh nga krahinat që u përmendën. Kjo është një e metë metodike e papranueshme. Ndikimi i turqishtes ka qenë për shekuj në gjithë Ballkanin, prandaj nuk mund të ketë dallime ndërmjet një fshati shqiptar dhe një tjetri për praninë apo mungesën e një njësie. Meqë kjo është një e metë e tillë, mund ta trajtoj pak me humor. Sipas këtyre listave, del se në Drenicë, Zadrimë e Çamëri për pesë shekuj nuk i paskan dëgjuar *myslimanët*; në Zadrimë e në Dibër nuk u paska rënë rasti të shohin ndonjë *hoxhë*; në Drenicë veshin *çorape*, kurse në katër krahinat e tjera nuk i paskan njohur; *bakllava* paskan ngrënë vetëm në Preshevë, gjithë shqiptarët e tjerë nga Zadrima deri në Çamëri nuk e paskan shijuar; qenka fat i madh që *budallenj* nuk paska në Zadrimë e në Dibër.

Si përfundim, është bërë një punë e madhe, por me rezultate të dobëta për shkak të metodës mekanike përgjithësisht të gabuar, e në veçanti nga ngatërrimi me trajtat dialektore dhe të rrethanave të dygjuhësisë, duke dalë një tablo e padobishme e huazimeve turke të shqipes.

Do të më lejohet, që të bëj një pohim, i cili besoj se shpreh një të vërtetë. Në kohën tonë gjuhëtarët shqiptarë kanë arritur një nivel jo të keq të shqyrtimit shkencor të shqipes, ndërsa kanë një përparësi të padyshimtë: ata e kanë shqipen gjuhë amtare; shumë anë të saj për ata janë të kapshme dhe të shpjegueshme më me përpikëri sesa mund ta bëjnë dijetarët e huaj, pavarësisht prej nivelit shkencor të këtyre ose të njohjes më të thellë të zhvillimeve të sotme të dijes. Nuk do të paraqes raste konkrete të tjera këtu, por jo rrallë te punime të albanologëve të njohur kam vënë re shembuj të gabuar të shqipes, diçka që një gjuhëtar shqiptar nuk do ta bënte jo sepse është më i zoti, por sepse kjo është gjuha e tij, sepse ai zotëron atë që quhet kompetenca gjuhësore dhe ndjenjën gjuhësore, të cilat rrallë një i huaj i arrin plotësisht. Nga N. Borecki po sjell sërish ndonjë shembull përtej çdo përfytyrimi. Jepet si turqizëm *pishëvënë* nga tq. *pezevenk*. Asnjë shqiptar nuk mund ta bëjë një gabim të tillë, sepse nuk e lejon kompetenca e vet gjuhësore. Asnjë shqiptar nuk mund ta pranojë se *kryelane*, për një lloj gatese, qenka prej një fjale për një kalë race arab nga tq. *küheylan*. *Gjedhesh tër* siç e ka trajtuar E. Çabej, nuk ka asnjë lidhje me tq. *güzešte*. Prej këtij pohimi rrjedh, se gjuhëtarët shqiptarë nuk kanë përse t'i druhen shqyrtimit kritik të ndihmesave nga autorët e huaj. Përkundrazi, kemi mundësinë të tregojmë se *pizeveng* vjen nga armenishtja si fjalë sharëse, ndërsa *manushaqe* gjithashtu vjen nga armenishtja dhe janë të kota përpjekjet për ta shpjeguar nëpërmjet ndryshimeve fonetike të tq. *menekşe*.

Por shqyrtimi kritik nuk na duhet si qëllim në vetvete, qoftë edhe për të vënë në vend saktësinë shkencore. Në rast se do t'i ndjekim nga afër punimet e albanologëve dhe do t'i shqyrtojmë me vëmendje, krijohet mundësia për të vendosur një dialog, madje edhe një bashkëpunim.